

Data: 29.04.2024

Vendi: Salla e takimeve në NP "Termokos"

Ora: 13.23- 15.00

Të pranishëm:

Visar Vokrri- kryesues i BD-së
Shukrije Morina- anëtare
Vesa Kelmendi- anëtare
Mentor Maliqi- anëtar
Fisnik Osmani- KE
Arton Shabani- ZKFTH

Rendi i ditës:

1. Konstatimi i kuorumit për mbajtjen e mbledhjes
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit të punës dhe financiar shkurt 2024
4. Raportimi për sezonin ngrohës 2023/2024
5. Raport mbi projektet kapitale të ndërmarrjes
6. Të ndryshme

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve ka hapur mbledhjen në ora 13.23.

Konkluzion: Bordi i Drejtorëve miratoi unanimitisht rendin e ditës.

1. **Konstatimi i kuorumit për mbajtjen e mbledhjes**

U konstatua kuorumi për mbajtjen e mbledhjes me prezencën e gjithë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Konkluzion: Kuorumi ekziston.

2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Visar Vokrri: Pasi që nuk e kemi pranuar ende procesverbalin e mbledhjes së kaluar, nuk mund ta miratojmë, por mbetet që në mbledhjen e ardhshme t'i sigurojmë dhe t'i miratojmë edhe procesverbalin e mbledhjes së kaluar edhe të mbledhjes së sotme.

Konkluzion: Procesverbalet nga mbledhja e V-të dhe e VI-të e BD-së do të shqyrtohen dhe miratohen në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës dhe financiar shkurt 2024

Visar Vokrri: Si zakonisht raportet i diskutojmë në mënyrë të detajuar, dhe meqenëse raporti siç e do rendi është diskutuar në detaje në mbledhjen e Komisionit të Auditimit, e kisha lutë Shukrijen nëse mund të na paraqesë një rezymë.

Shukrije Morina: Ne në Komisionin e Auditimit e kemi diskutuar Raportin e punës dhe atë financiar për muajin shkurt. Raportin e kemi pranuar më 26.03.2024. E kemi shqyrtuar në detaje në disa pika. Është një dallim sa i përket sipërfaqes ngrohëse dhe energjisë termike të prodhuar. Derisa ka rritje të sipërfaqes ngrohëse, energjia termike e prodhuar nuk korrespondonte me atë rritje. Unë e kam bërë një kalkulim dhe nuk më dilte saktë. Por, pasi që mora përgjigjen nga Artoni se pasi që temperaturat e ajrit kanë qenë më të larta, nuk ka pasur nevojë për më shumë energji, atëherë jemi në rregull.

Fisnik Osmani: Ne punojmë sipas diagramit rrëshqitës, marrjen e energjisë nga KEK-u ia përshtasim temperaturave të ajrit. Dallimin e bëjnë sidomos institucionet publike, të cilat faturohen me matës e jo me $m/2$.

Visar Vokrri: Sa është kapaciteti maksimal, që marrim nga KEK-u?

Fisnik Osmani: Ne e bëjmë nominimin 24 orë përpara, varësisht nga temperaturat. Nëse e marrim në terma absolut, do të duhej, që të rritej edhe konsumi, por tek banesat e reja nevoja për konsum është më e ulët, për shkak të efijencës më të lartë.

Shukrije Morina: Në aspektin financiar ndërmarrja ka operuar me fitim prej 898 mijë euro.

Vesa Kelmendi: Po i kemi diskutuar edhe humbjet e ujit. Do t'ishte mirë të na informoni, nëse janë marrë masa për zvogëlimin e humbjeve të ujit, që të mos rrijmë në këtë tendencë.

Fisnik Osmani: Ne kemi tendencë, që humbjet e ujit të shkojnë në 0, por është e pamundur. Ka disa vende, që mund të ndërhyjmë, ka vende që nuk mund të ndërhyjmë. Janë kryesisht në rrjetin primar. E kemi marrë seriozisht raportin e Zyrës së Auditorit të Brendshëm për identifikimin e rrjedhjeve. Kemi marrë masa që të evidentohen rrjedhjet dhe të evitohen ato. Nuk mund t'i evidentojmë ato nëpërmes sistemit. Ka raste kur ka rrjedhje të mëdha në rrjet dhe lajmërohem edhe nga qytetarët.

Visar Vokrri: A ka ndonjë analizë, matje për to?

Fisnik Osmani: Vitin e kaluar kanë qenë 11-12%. Është në marzhën e normales. Ka ditë ose ka javë, që e kemi kërkuar një rrjedhje dhe na ka dalë një tek busti i Bob Dollit. Pasi

është intervenuar dhe sanuar ajo rrjedhje, humbjet e ujit nga mbi 400m/3 kanë rënë tek 200m/3.

Vesa Kelmendi: Vërejtja tjetër është tek investimet kapitale, duhet që raporti të korigjohet dhe të shtohet edhe objekti. Më shumë se një herë e kam kërkuar. Para se të plotësohet deri në fund të muajit nuk dua të merrem më me të. Tek ky raport e kemi pasur edhe një kërkesë, që të plotësohet edhe me pjesën e burimeve njerëzore.

Fisnik Osmani: Po mund të bëhet edhe ky plotësim.

Visar Vokrri: Cilat të hyra hyjnë në kategorinë të hyrat tjera operative?

Arton Shabani: Në atë kategori hyjnë taksat për kyçje, rikyçje, punë me palë të treta etj.

Visar Vokrri: Sa është taksa për kyçje?

Fisnik Osmani: Po, është një taksë 100 euro.

Arton Shabani: Tek KEK-u kemi pasur një borxh diku 300 mijë euro, edhe fatura e fundit, tash i kemi diku 643 mijë euro.

Visar Vokrri: Pse është ai borxh tek KEDS, 716 mijë euro?

Arton Shabani: Është një borxh i mëhershëm.

Vesa Kelmendi: Edhe për "Brunata" na thanë, që është fatura e fundit.

Fisnik Omsani: E shohim në konsultim me PIU-në. Jemi në kontakt me konsulencën, që të shohim se si do të bëhet për ato, që kanë mbetur.

Vesa Kelmendi: Pyeta për kriptën se pse tash në fund të sezonës është porositur. Më thanë se janë porositur se ka qenë nga fundi i kontratës.

Arton Shabani: Tek KEK-u janë dy fatura të papaguara, tek KEDS është edhe një borxh i mbetur. Tek "Euroni salt" i ka dalë kontrata, anadaj janë porositur sasisë e kripës para skadimit të kontratës.

Tash pas përfundimit të sezonit faturat vijnë duke u ulur.

Visar Vokrri: A ka ndonjë koment tjetër?

Pasi që BD nuk pati komente tjera rreth këtij raporti, kryesuesi e ka hedhur në votim miratimin e raportit.

Konkluzion: Bordi i Drejtorëve unanimisht ka miratuar Raportin e punës dhe financiar për muajin shkurt 2024.

4. Raportimi për sezonin ngrohës 2023/2024

Fisnik Osmani: Siç jeni informuar, të premten pas 195 ditësh furnizim me ngrohje, pa asnjë ditë ndërprerje kemi përmbyllur sezonin ngrohës 2023/2024.

Kemi kaluar shumë më mirë se që kemi pritur. Duhet të cekim se edhe temperaturat kanë qenë të mira.

Sipas raporteve, që janë nxjerrë deri më tash, kemi pasur rritje të faturimit për 15% apo shprehur në përqindje 1.4 milion më tepër se në sezonin e kaluar. Për periudhën e njëjtë inkasimi është rritur 23% apo 1.8 milion euro më shumë. Si rezultat i zgjerimit të rrjetit kemi arritur rreth 2 milion m/2 sipërfaqe ngrohëse aktive dhe pasive. Numri i konsumatorëve është rritur për 22%. Nga KEK-u është ekstraktuar 14.6% më tepër energji, ndërsa humbjet e ujit kanë qenë 11.7%.

Raporti do t'i përcillet edhe Bordit të Drejtorëve.

Falenderoj punëtorët për gjithë angazhimin dhe juve Bordin e Drejtorëve për përkrahjen. Me stafin kemi mbajtur dy takime për draftin parafinal të Planit aksional për punët, që do të kryhen gjatë verës. Me kapacitetet tona, që kemi në dispozicion do të vazhdojmë të kycim një xhami dhe një shkollë në rrjetin e ngrohjes, përveç tjerash.

Para një muaji kam pasur një takim me dy këshilltarë të ministres së ekonomisë. Kemi shqyrtuar mundësinë, që ministria të mbështesë ndërmarrjen. Kemi marrë një feedback shumë të mirë për të na ndihmuar në zgjerimin e rrjetit. Mbetet të shihet tutje, të shohim rezultatet.

Visar Vokrri: Është mirë që të shfrytëzohet kjo periudha për të kryer punët.

Fisnik Osmani: Kjo është një punë operative e rregullt. Bëhet pastrimi i këmbyesve, valvolave etj.

Visar Vokrri: Ne kemi nevojë për një seri të takimeve me ZRRE-në para përcaktimit të tarifave të reja. A kemi mundësi, që nga tetori të dërgojmë faturat me pliko?

Fisnik Osmani: Po, patjetër.

Vesa Kelmendi: Kur ka mundësi të kemi të dhëna nga faturimi sipas konsumit?

Fisnik Osmani: Tek këto 1008 faturat, që janë dërguar, 33% e konsumatorëve kanë marrë fatura më të ulëta.

Ne po dëshirojmë të analizojmë se sa do të ndikojnë faturat e para, që konsumatorët e njëjtë të kursejnë energjinë.

Visar Vokrri: Ne duhet të jemi të kujdesshëm në mënyrën se si do t'ia transmetojmë audiencës këtë.

Fisnik Osmani: Fushata e informimit është duke u përgatitur nga PIU.

Konkluzion: Fushata e informimit për ndryshimin e mënyrës së faturimit të përgatitet me kujdes të shtuar për mesazhet, që do t'i përcillen audiencës.

5. Raport mbi projektet kapitale të ndërmarrjes

Visar Vokrri: Nëse jeni dakord, për shkak se nuk i kemi të dhënat e detajuara të gatshme për sot, këtë pikë për investime kapitale mund ta shtyejmë për mbledhjen e radhës?

Konkluzion: Bordi i Drejtorëve u dakorduan, që të shtyhet për mbledhjen e radhës diskutimi për investimet kapitale dhe që paraprakisht të merret një raport i detajuar nga Njësia e ndërmarrjes për implementimin e projekteve.

6. Të ndryshme

Arton Shabani: Janë disa kërkesa për sponsorizim.

Kemi kërkesën e sindikatës. E njoftova më herët edhe Komisionin e Auditimit, që Sindikata e punëtorëve ka kërkuar mbështetje për një ekskurzion në Shqipëri. Nga Komisioni i Auditimit u kërkuar që t'ju përcjellim edhe kërkesën me shkrim dhe ofertën, që ka pranuar Sindikata për ekskurzion.

Kemi pranuar 4 kërkesa për sponsorizim bazuar në Ligjin për sponsorizim: klubi i volejbollit "Prishtina 75", Infinit Training Center, klubi i skitarisë "Pro One Pro01" dhe futsal "FC Mabatex Prishtina". Vitin e kaluar kemi përkrahur 4 organizata, 2 i kanë kompletuar kërkesat, 2 jo dhe kanë mbetur pa u mbështetur.

Visar Vokrri: Le të na dërgohen këto kërkesa dhe mund t'i shqyrtojmë ne në mbledhjen e radhës.

Konkluzion: Kërkesat e Sindikatës së punëtorëve për përkrahjen në organizimin e ekskurzionit në Shqipëri dhe kërkesat për sponsorizim t'i dërgohen me shkrim BD-së për shqyrtim.

Fisnik Osmani: Sa i përket ndarjes së bursave siç jeni të informuar janë ndarë 15 bursa për studentë. Përzgjedhja e studentëve ka përfunduar, por ne nuk e kemi bërë ekzekutimin pa e marrë miratimin e Bordit të Drejtorëve.

Visar Vokrri: A e kemi diskutuar vitin e kaluar?

Vesa Kelmendi: Po e kemi shqyrtuar edhe vitin e kaluar. Është e buxhetuar.

Fisnik Osmani: Po, e kemi diskutuar.

Konkluzion: Bordi i drejtorëve u dakordua, që të vazhdohet me pagesat e bursistëve.

Fisnik Osmani: Kemi edhe një çështje tjetër. E kemi buxhetuar edhe shumën për analizën e kaldajave, rezervuarve të mazutit në Departamentin e prodhimit. Kemi bërë një marrëveshje me Fakultetin Teknik për të realizuar këtë. I kemi caktuar edhe njerëzit, që do të merren me këtë. Dëshirojmë të kemi një raport përfundimtar nga profesorët për gjendjen e kaldajave dhe rezervuarve të mazutit, që ta dijmë si t'i trajtojmë më tutje, të kemi një vlerësim të saktë se a mund të mbështetemi në kaldajat ekzituese në rast se bie

KEK-u nga sistemi, a kemi nevojë për rezervuaret e mazutit dhe si do të veprohet më tutje me ta, pasi që mazuti nuk do të përdoret më.

Vesa Kelmendi: A do të duhej të përfshihej edhe ndokush nga Komuna apo aksionarët, pasi që kjo ja jep një orientim ndërmarrjes për të ardhmen.

Fisnik Osmani: Pasi ta marrim raportin do ta ndajmë me Komunën, aksionarët dhe me ju. Më pas do të vendosim bashkarisht për hapat tutje.

Visar Vokrri: Siguronu që gjithçka është në rregull në aspektin e prokurimit, pasi që ne në këtë rast jemi duke kërkuar një shërbim.

Fisnik Osmani: Dhe e fundit për sot: janë dy çështje, që ndërlidhen me njëra-tjetrën. Me udhëzimin administrativ për rekrutimin e stafit obligohemi, që të kemi një rregullore të brendshme. Ne kemi punuar një draft. Kjo rregullore i jep super kompetenca burimeve njerëzore për rekrutimin e stafit. Janë disa pozita, që janë të shpërndara nëpër vende tjera si IT, PR etj., që do të duhej të sistemoheshin.

Shukrije Morina: A mund të bëni ju një draft?

Visar Vokrri: Ne kemi punuar një herë në skemën organizative dhe të bëhet prapë brenda një kohe kaq të shkurtër nuk di se si do të reflektohet kjo. Ne i kemi burimet njerëzore në kuadër të Departamentit të administratës?

Fisnik Osmani: Po e kemi vetëm një zyrtar. Ideja është që të forcohen më shumë burimet njerëzore.

Konkluzion: BD autorizoi menaxhmentin e ndërmarrjes të përgatis një draft rregullore me propozimet për ndryshimet e nevojshme në organogram.

Kryesuesi i BD-së shpalli të mbyllur mbledhjen në ora 15.00

Procesmbajtësja:
Afërdita Uka-Fejzullahu



Kryesuesi i BD
Visar Vokrri

